




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ref:1907/944/KPM/mf

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 1 dhe paragrafin 2 pika 6 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, në takimin e mbajtur me datë 24 korrik 2019, mori këtë:

V E N D I M

- I. FORMOHET grupi punues për inicimin e ndryshimit të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.
- II. Përbërja dhe detyrat e këtij grupi punues do të përcaktohen me Termat e Referencës të cilat do të nxjerrën bazuar në këtë vendim.

ARSYETIM

Komisioni i Pavarur për Media me datën 14 shkurt 2019, ka pranuar një kërkesë nga Oda Ekonomike e Kosovës përmes të cilës ka kërkuar nga KPM të iniciohet procedura e ndryshimit të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.

Oda Ekonomike në cilësinë e përfaqësuesit të anëtareve të saj në përbërje prej: KLAN KOSOVA, TRIBUNA CHANNEL dhe RADIO TELEVISIONI DUKAGJINI kërkesën për ndryshim të Rregullores, konkretisht rregullin për bartje të detyrueshme, e arsyeton se aplikimi i rregullit "Must Carry" i ve në pozitë të pabarabartë dhe diskriminuese këto televizione në raport me operatorët kabllor dhe nuk ju lejon rregullim të mardhënieve kontraktuale në mes tyre si televizione dhe operatorëve kabllor.

Oda Ekonomike sërish me datën 5 qershor 2019, përmes një letre i është drejtuar KPM-së me kërkesën që të iniciohet procedura për ndryshimin e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.

KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura si dhe duke u bazuar në nevojën e rishikimit të Rregullores KPM-2016/01 për shkak të ndryshimeve të rrethanave në kuadër të tregut medial, përfshi këtu edhe ndryshimet teknologjike, vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.


Muja FERATI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



25.07.2019
data